

# RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 08 —————>

MARS 2022



**R**INGJALLJE

**I**NVESTIM

**M**BËSHTETJE

**Q**ËNDRUESHMËRI

**K**OORDINIM

**P**UNËSIM

**M**IRËQENIE

**B**ARAZI

**J**ETËSIM

**E**KONOMI

# Rimëkëmbja e Gjelbër dhe Kosova →

## Për buletin

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) në mënyrë periodike bënë publikimin e buletinëve informues mbi procesin e zbatimit dhe monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Duke bërë informimin mbi Pakon e Ringjalljes dhe monitorimin e kësaj pako, INDEP synon rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve të Kosovës ndaj qytetarëve të saj. Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është i realizuar në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID.

Edicioni i tetë i buletinit do të ofrojë informata mbi politikat e gjelbërta të rimëkëmbjes, përfrimin e këtyre politikave me Pakon e Ringjalljes Ekonomike dhe rimëkëmbjen e gjelbër si një zgjidhje e duhur e tejkalimit të krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19. Në përgjithësi, ekonomia e Kosovës është goditur në mënyrë drastike nga pandemia. Humbja e vendeve të punës, rrezikimi i punëtorëve, ndërprerja e aktiviteteve ekonomike dhe mbylljet si rrjedhojë e parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19 janë disa nga shkaktarët që Bruto Produkti Vendor (BPV) të goditet dhe të dëmtohet. Duke pasur parasysh këtë, zgjidhje afatgjate dhe e qëndrueshme, e në të njëjtën kohë zgjidhje e cila ofron një rimëkëmbje nga pandemia mbetet integrimi i politikave të gjelbërta në pakot stimuluese.

## ÇKA ËSHTË RIMËKËMBJA E GJELBËR?



Pandemia COVID-19 po i paraqet botës sfida kolosale. Do të ketë një ndikim në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm në shumë fusha të jetesës. Në të njëjtën kohë, ndryshimet klimatike po kërcënojnë çdo ditë e më shumë jetesën e shumë njerëzve. Megjithatë, këto kriza të dyfishta mund të jenë gjithashtu një mundësi e ndryshimit të orientimeve në fusha të tjera, nëse trajtimi i tyre bëhet në frymën e një rimëkëmbjeje të gjelbër përmes të cilës mund të arrihet mundësia e sjelljes së një sistemi të qëndrueshëm ekonomik.

Rimëkëmbja e gjelbër nënkupton masa që luftojnë ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19. Duke ditur vështirësitë si rrjedhojë e pandemisë dhe në anën tjetër krizat klimatike, politikat e gjelbërta dhe rimëkëmbja e mbështetur në to është një nga metodologjitë më të mira të tejkalimit të të dy krizave paralelisht. Një rimëkëmbje e tillë siguron vende të reja të punës, zhvillim më të hovshëm ekonomik dhe përafrim me direktivat e shteteve evropiane dhe Bashkimit Evropian.



Rimëkëmbja e qëndrueshme kërkon ndërhyrjen e politikave në shumë fusha zhvillimore, e jo vetëm stimulum fiskal për tejkalimin e përkohshëm të krizave dhe vështirësive. Politikat dhe përgjigjet ndaj rimëkëmbjes duhet të jenë të gjera në aspektin e gjithëpërfshirjes, zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe në shumë sfera të tjera. Në këtë mënyrë, pakot e rimëkëmbjes duhet të bazohen në parimin e zhvillimit produktiv. Politikat e zhvillimit produktiv mund të përkufizohen gjerësisht si politika që synojnë të forcojnë strukturën prodhuese të një ekonomie të caktuar kombëtare, përmes krijimit të vendeve të punës, zhvillimit ekonomik, forcimit të stabilitetit dhe arritjes së qëndrueshmërisë afatgjate.

Nevoja për të miratuar politika dhe rimëkëmbje me karbon të ulët dhe në hap pozitiv me ndikimet klimatike është thelbësore. Nëse përmes pakove financohen dhe shtyhen përpara projekte të gjelbërta, atëherë mund të arrijmë fitorë të dyfishtë, pra duke arritur rimëkëmbje ekonomike dhe tejkalim të vështirësive nga pandemia COVID-19, e në anën tjetër duke arritur synimet e emetimit të ulët të gazrave serrë. Promovimi i tranzicionit të energjisë, ku përfshihen projekte të reja të gjenimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme do të sjellte mundësi për vende të reja të punës, do të ndihmonte uljen e nivelit të emetimit të gazrave serrë, e gjithashtu do të ndihmonte rimëkëmbjen e cila do të ishte e gjelbërt dhe efiçente.



## PAKOT E KALUARA STIMULUESE NË KOSOVË

Pako Emergjente Fiskale dhe Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike kishin për synim adresimin dhe zgjidhjen sa më të mirë të problematikave të paraqitura nga shfaqja e pandemisë e deri më tani. Por përpos kësaj, pakot e mëparshme por edhe pako aktuale kanë të përbashkët një gjë, e cila është vetëm mbulimi i disa hallkave të hapura nga pandemia, e jo avansimi dhe rimëkëmbja e gjelbërt dhe e qëndrueshme për të ardhmen. Kjo si pasojë e mungesës së parimeve për caktimin e masave të cilat do të ndihmonin në krijimin e vendeve të reja të punës, ndikimin në tranzicionin energjetik dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Pakot e kaluara stimuluese të implementuara në Kosovë nuk përafrojnë politika të gjelbërta e rrjedhimisht edhe impakti i tyre nuk ishte i kënaqshëm. Një metodologji e tillë e përdorur nga ana e Qeverisë së Kosovës përmes pakove të miratuara nga ana e saj ishte tentim i tejkallimit të problemeve aktuale të paraqitura nga pandemia COVID-19 dhe jo strategji afatgjate dhe e qëndrueshme. Rimëkëmbja e tillë është e gabuar dhe rrjedhimisht e paqëndrueshme në aspekte kohore afatgjate. Prandaj fokusi kryesor duhet të jetë në tranzicionin energjetik, krijimin e vendeve të reja të punës dhe në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, në mënyrë që tejkallimi i pandemisë të arrihet përmes sigurimit të një rimëkëmbje afatgjate edhe për krizat e tjera eventuale në të ardhmen.



**PAKO  
EMERGJENTE  
FISKALE  
165 MILIONË  
EURO**

**PAKO E  
RIMËKËMBJES  
EKONOMIKE  
222.4 MILIONË  
EURO**

**GREEN POLICIES  
NOT INCLUDED**

**GREEN POLICIES  
NOT INCLUDED**

## PARIMET E RIMËKËMBJES SË GJELBËR NË PAKON E RINGJALLJES EKONOMIKE →

Pako aktuale e cila është e miratuar dhe është duke u implementuar, ka të alokuara 420 milionë euro, dhe në qendër të ndihmave ka ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha. Rritja progresive e pakove të rimëkëmbjes ka shkuar edhe paralelisht me faktin që pandemia COVID-19 i rezistoi kohës dhe ishte relativisht prezente për gjatë gjithë kohës nga shfaqja e rasteve të para deri tani në mars të vitit 2022. Mirëpo duke ditur edhe problematikat tjera, normalisht që kjo pako ka pasur mundësi të dizajnohet më mirë dhe në atë mënyrë që impakti i saj të mos jetë vetëm për ballafaqimin me problemet aktuale, por të jetë bazë e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe produktiv për të gjithë sektorët e zhvillimit ekonomik dhe sferat e tjera të jetesës.

Pako e Ringjalljes Ekonomike përmban pesë masa kryesore. Mirëpo vetëm masa e pestë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është në një linjë me politikat e gjelbërta. Për fat të keq, kjo masë ende nuk ka filluar të implementohet dhe mos operacionalizimi i saj nënkupton shtim të problemeve dhe ngadalësim i tejkalimit të krizës. 100 milionë euro që janë të dedikuara për këtë masë do të duhej që tashmë të jenë të shpërndara në sektorin energjetik si një sektor shumë i rëndësishëm për zhvillim ekonomik të vendit, në diversifikimin e burimeve të energjisë si dhe në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike.





Me fjalë të tjera, duke pasur parasysh përmasat e tkurrjes ekonomike dhe kohëzgjatjen e pritshme të saj, Qeveria e Kosovës duhet të ketë udhëzime të qarta se si të prioritetizojë shpenzimet dhe ndërhyrjet e saj krahas tejkalimit të pandemisë COVID-19. Në disa raste, si rimëkëmbja e gjelbër dhe nevoja për të reduktuar pabarazinë, është e nevojshme një perspektivë afatgjatë. Ndër të tjera, të tilla si subvencionimet apo mbështetja përmes të hollave për kategori të caktuara, garancitë e kredisë, uljet e taksave për të shmangur falimentimet dhe subvencionet e pagave janë ndërhyrje afatshkurtra për tejkalimin e disa problemeve momentale. Qeveria do të duhej të vendosë këtë ekuilibër, duke synuar në mënyrë paralele ndërhyrjet që kombinojnë ndikimet sociale dhe mjedisore me produktin afatshkurtër dhe gjenerimin e punësimit për një periudhë më afatgjatë.

Pako e Ringjalljes Ekonomike do të duhej të përfshinte politika të cilat ndihmojnë avansimin e proceseve të gjelbra, dhe të cilat për afrojnë Kosovën me standardet evropiane. Disa masa të cilat do të ndihmonin rimëkëmbjen ekonomike, do të krijojnë vende pune dhe njëkohësisht do të mbronin mjedisin janë:

- Stimulimi dhe subvencionimi i Prosumers (Konsumatorët me vet-konsum)
- Investimi në bateri për konservim të energjisë elektrike
- Investime në rrjetin elektrik, përmes të cilave do të zvogëloheshin humbjet teknike
- Investime në projekte të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme



## REKOMANDIME



- Qeveria e Kosovës të hartoj pako stimuluese me përfshirjen e politikave të gjelbërta. Qeveria duhet të prioritetizojë mbështetjen për shtimin e gjeneruesve të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Këto projekte duhet të sigurohet që të ofrojnë vende të reja pune, diversifikim të gjenerimit, mbrojtje të mjedisit dhe tranzicion energjetik. Stimujt në pakot e ardhshme të jenë profitabile edhe për vendin por edhe për investuesit, në mënyrë që të shpejtohet rimëkëmbja dhe të arrihen objektivat e përcaktuara nga direktivat europiane.
- Të bëhet përfshirja e masave të cilat mbrojnë mjedisin dhe krijojnë vende të reja pune. Pandemia COVID-19 mund të shfrytëzohet edhe për vënjen e bazës së zhvillimit të së ardhmes dhe nuk duhet të përfshihen në pakot stimuluese vetëm masa të cilat kontribuojnë në tejkalimin e krizës aktuale. Karshi tranzicionit energjetik, masat dhe mbështetja financiare për sektorin e energjisë do të ndihmonin krijimin e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë energjetike në të ardhmen.
- Qeveria e Kosovës të largoj taksat e pajisjeve të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Heqja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar e cila është 18% për këto pajisje, do të stimulojë investitorët që të investojnë në projekte të reja në Kosovë. Një politikë e tillë ndihmon tranzicionin energjetik, hap vende të reja pune dhe mundëson shpejtësinë e procesit të dekarbonizimit.
- Të investohet në efijencë të energjisë, infrastrukturë për makinat elektrike dhe centrale të gjenerimit të energjisë përmes burimeve të ripërtëritshme. Përmes investimeve në këto fusha do të krijohen vende të reja të punës, përmirësohet kualiteti i jetesës, bëhet reduktimi i emetimit të gazrave serrë, kursehen mjetet financiare dhe mundësohet zhvillimi i mëtutjeshëm dhe më i qëndrueshëm i shumë fushave të jetesës. Andaj Qeveria e Kosovës të hartojë pako të cilat do të mbështeten në këto pika si bazë e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19.





“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”